



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT / OFFICE OF THE PRIME MINISTER / URED
PREMIJERA

AGJENCIA PER BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST
POLOVA / AGENCY OF GENDER EQUALITY

Datë: 01/11/2022

Ref: 502/2022

RAPORT

Implementimi i thirrjes publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve të OJQ-ve që kontribuojnë në :

Shënimin e 25 Nëntorit, Fushatës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, ndryshe si 16 Ditë të Aktivizmit, e cila fillon me 25 Nëntor dhe zgjatë deri me 10 Dhjetor në Ditën Ndërkombëtare për të Drejta të Njeriut

Hyrje

ABGJ me datën 06/10/2022 ka shpallur thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, që kontribuojnë në ngritjen e vetëdijes dhe ndërgjegjësimit të përgjithshëm për luftën kundër dhunës ndaj grave, në zbatimin e prioritetëve të parapara në Objektivat Strategjike të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022- 2026 dhe planit të tij të veprimit, respektivisht

Objektiven I: Parandalimi dhe identifikimi i dhunës nëpërmjet edukimit dhe vetëdijesimit.

Objektivi specifik

1.1 : Ndryshimi i sjelljeve qëndrimeve, roleve dhe stereotipeve gjinore që justifikojnë dhunën.

Veprimi 1.1.7 : Aktivitete vetëdijësuese përgjatë fushatës së 16 Ditëve të Aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje (25 nëntor – 10 dhjetor 2022).

Qëllimi

Agjencia për Barazi Gjinore përmes kësaj thirrjeje është në zbatim të drejtpërdrejtë të Strategjisë Kombëtare për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022-2026 dhe planit të tij të veprimit, respektivisht,

Objektiven I: Parandalimi dhe identifikimi i dhunës nëpërmjet edukimit dhe vetëdijësimit dhe Ligjit për Barazi Gjinore neni 7 pika 1.7.

2 Fushata vetëdijësuese duhet të arrijnë qëllimin në 3 fusha:

- I. Vetëdijësimi dhe mobilizimi i shoqërisë, për të mos toleruar dhunën ndaj grave, dhunën në familje, për promovimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtje nga diskriminimi.
- II. Vetëdijësimi i shoqërisë mbi zingjirin institucional të përkrahjes së rasteve të dhunës, si dhe shenjat identifikuese, parandalimin dhe referimin e rasteve të dhunës ndaj grave, dhe
- III. Luftimi i stereotipeve përmes angazhimit të burrave dhe djemve në eliminimin e dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe promovimin e barazisë gjinore.

Agjencia për Barazi Gjinore ka realizuar këtë thirrje publike duke respektuar standardet me të larta të konkurrencës, transparencës dhe vendim marrjes në përputhje me rregulloren MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Në kuadër të kësaj thirrje publike Agjencia për Barazi Gjinore ka pranuar aplikimet e gjithsej 7 Organizata Jo Qeveritare të cilat para vlerësimit të projekteve të tyre komisioni ka bërë kontrollin administrativ të secilit aplikacion.

Lista e të gjithë aplikantëve (OJQ-ve) që kanë aplikuar në kuadër të kësaj thirrje publike janë:

1. QMGF-ZANA –Emri i projektit: “Mos e shëndrro dhunën në dhunti”.
2. OJQ DIJA JONE-Emri i Projektit “Promovimi i të drejtave të grave të komunitetit RAE dhe fuqizimi i rolit të tyre në sfidimin e dhunës në familje”.
3. OJQ QENDRA PER EDUCATION AND COMMUNITY DEVELOPMENT –FRIENDS-Emri i Projektit “Jetë pa dhunë në familje”.
4. OJQ WOMEN WORLD TODAY AND NOW(WWTN) –Emri i projektit: “Mekanizmat ligjor dhe institucional për parandalimin e dhunës dhe diskriminimit të grave në Kosovë”.
5. OJQ BUSSINES WOMEN MITROVICA-Emri i Projektit: “Avokimi për të drejtat e barabarta të grave dhe vajzave në komunën e Mitrovicës”.
6. OJQ ORGANIZATA RINORE AKTI-Emri i projektit “Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i mekanizmave shoqëror dhe institucional në parandalimin e dhunës dhe stereotipave gjinore”.
7. OJQ APRFK AVANCIMI I POZITES TE RINISE DHE FEMIJEVE NE KOSOVE-Emri i projektit: “Fuqizimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut”.

Vlerësimi

Agjencia për Barazi Gjinore ka themeluar Komisionin vlerësues me nr të vendimit 497/2022 përberë nga 3 zyrtar të ABGJ-së dhe dy anëtar/e përfaqësues nga Shoqëria Civile gjegjësisht ekspert të jashtëm, ku kishte për detyrë të vlerësoj të gjitha aplikacionet e paraqitura në kuadër të thirrjes publike.

Komisioni Vlerësues i themeluar sipas thirrjes dhe në përputhje me kërkesat e Rregullores MF-Nr. 04/2017, në prezencë të të gjithë anëtarëve ka bërë hapjen dhe vlerësimin e çdo aplikacioni dhe sipas thirrjes publike dhe kriterëve; a) kriteret e përgjithshme dhe b) kriteret specifike të cilat ishin baza për kualifikim të aplikantëve për mbështetje publike financiare sipas neneve 10 dhe 11 të rregullores MF-Nr.04/2017, komisioni ka vlerësuar dhe ka ardhur në përfundim se vetëm tre(3)OJQ do të mbështeten për subvencionim.

OJQ-të përfituese janë:

- 1) OJQ ORGANIZATA RINORE AKTI-Emri i projektit "Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i mekanizmave shoqëror dhe institucional ne parandalimin e dhunës dhe stereotipave gjinore"
- 2) OJQ BUSSINES WOMEN MITROVICA-Emri i Projektit:"Avokimi për te drejtat te barabarta të grave dhe vajzave ne komunën e Mitrovicës.
- 3) OJQ QENDRA PER EDUCATION AND COMMUNITY DEVELOPMENT -FRIENDS-

Anetarët e Komisionit

Adelina Kajtazi-Kryesuese

A. Kajtazi

Refiqe Murtezi -Anëtare

R. Murtezi

Shqipe Arifaj-Anëtare

S. Arifaj

Leonora Selmani-Anëtare

L. Selmani

Besa Zogaj -Anëtar

B. Zogaj



